



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Vlerësimi i situatës së papunësisë së grave dhe vajzave në zonën migratore të Ish-Kënetës Durrës


Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"





Vlerësimi i situatës së papunësisë së grave dhe vajzave në zonën migratore të Ish-Kënetës Durrës

Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"



NO _ City

Tiranë, Dhjetor 2015

Përgatitja e botimit u mundësua nga OSFA – Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, në kuadër të projektit “Vlerësimi i situatës së papunësisë gjinore në zonën migratore të Ish-Kënetës Durrës” zbatuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Soros

Bashkëautorë:

Bernard Zeneli
Manjola Stefani
Fabiola Egro

Kontribuan me sugjerime, rekomandime:

Meme Xhaferaj -Drejtoresh e Drejtorisë së Shërbimit Social -Bashkia Durrës
Indrit Buka - Drejtor i zyrës Rajonale të Punësimit -Durrës
Aurora Hyka - Specialiste e Barazisë Gjinore -Bashkia Durrës

Falenderime i dedikohen grave dhe vajzave të zonës së Ish-Kënetës, Durrës që dhanë informacionin aktual me të cilin u mundësua hulumtimi sasior dhe cilësor i situatës gjinore në lidhje me papunësinë/punësimin.

Falenderohen gjithashtu Bashkia Durrës dhe Institucionet publike vendore që mundësuan informacionin statistikor krahasimor, si dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë që mbështeti realizimin e këtij projekti.

Përmbajtja

PARATHËNIE	4
QARKU I DURRËSIT	5
Ish – Këneta, Durrës	6
METODOLOGJIA	6
VLERËSIMI I SITUATËS SË PAPUNËSISË SË GRAVE DHE VAJZAVE NË ZONËN E ISH-KËNËTËS DURRËS	8
Të përgjithshme	9
Popullsia e Ish-Kënetës	11
Përbërja e Popullatës sipas Kampionimit	11
Përbërja familjare	12
Statusi civil i të intervistuarave	13
Niveli i Arsimit	13
Mosha mesatare sipas arsimit	14
PAPUNËSIA DHE FAKTORËT NDIKUES	15
Papunësia femërore sipas kampionimit	16
Niveli Arsimor i Grave dhe Vajzave të Papuna	16
Papunësia sipas grupmoshave krahasuar me numrin e përgjithshëm të grave të papuna	17
Niveli Mesatar i papunësisë sipas grupmoshave	18
Korelacioni arsim - papunësi në grupmoshë	18
Niveli i kualifikimeve të grave të papuna, ndihma ekonomike në familjet e tyre dhe pu.papunë të regjistruar	20
Faktorët Primarë ndikues në Nivelin e Papunësisë dhe Nënkatëgoritë e tyre	20
PUNËSIMI FEMËROR	23
Punësimi sipas arsimit në sektorë	25
Të ardhurat sipas sektorit të punësimit	26
Tipologjia e punës dhe informaliteti ndërsektorial	27
Punësimi sipas gjinive	29
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	30
BIBLIOGRAFI	35

Parathënie

Gjatë viteve të fundit Shqipëria është përballur me krizë ekonomike dhe politike që kanë dëmtuar cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë. Kjo vihet re në nivelin e lartë të papunësisë, dhunës dhe në pasigurinë e përgjithshme të njerëzve. Papunësia afatgjatë dhe si pasojë e mospasigurimit, është më tepër karakteristikë e grave punëkërkuese, ndërsa papunësia e personave të kualifikuar dhe me diplomë vihet re si një tendencë alarmuese të rinjtë e të dy gjinive.

Ndërkohë që ekzistojnë studime statistikore për papunësinë femërore dhe të rinjë në nivel rajonal, të dhënat në bazë vendore mungojnë. Pavarësisht dëshirës së mirë apo përpjekjeve të bëra në nivel kombëtar të qeverisjes për të fuqizuar politikën e punësimit dhe një sektor formimi profesional dhe inovativ, pak është bërë në nivel vendor. Studimet ekzistuese e trajtojnë problemin e papunësisë dhe të kualifikimit të forcës së punës, vetëm në nivel kombëtar dhe rajonal dhe ofrojnë opsione zgjidhjeje dhe trajtimi nga lart-poshtë.

Zhvillimet e fundit politike në Shqipëri, përfshirë dhe formimin e një qeverisjeje të majtë dhe përsheptimin e procesit drejt Bashkimit Europian, kanë krijuar oportunitete për rikonsiderimin dhe përmirësimin e politikave publike mbi adresimin e çështjeve kryesore si dhuna, papunësia, arsimi, shërbimet publike etj., ndërkohë që Reforma Territoriale do të ofrojë akoma me shumë shanse për zhvillimin lokal. Nga ana tjetër, reforma parashikon dhe konsolidimin administrativ dhe midis të tjerave dhe rritjen e aftësisë për të ofruar një gamë më të madhe shërbimesh me cilësi më të lartë dhe më kosto administrative më të ulët.

Qarku i Durrësit

Përveç kontekstit të përgjithshëm që prek vendin, në veçanti, qarku i Durrësit karakterizohet nga një shkallë e lartë emigrimi të jashtëm dhe të brendshëm që ka ndryshuar në mënyrë drastike statusin e tregut të punës në lidhje me kualifikimet dhe aftësitë, sidomos të gratë dhe të rinjtë. Ka një nevojë të rëndësishme për krijimin e një rrjeti aktiv dhe të qëndrueshëm të tregut të punës bazuar në studime mbi nevojat lokale të tregut të punës. Sa më sipër ngrenë diskutime mbi nivelin cilësor, sasior dhe gjithëpërfshirës të bazave të forta që mbështesin reformat dhe strategjitë kombëtare.

1) Ka lindur nevoja për të vlerësuar në mënyrë analitike papunësinë femërore dhe të të rinjve duke e pasuruar më tej me të dhëna statistiko-re për secilën njësi të qeverisjes vendore dhe me analizë krahasimore me të dhënat në nivel kombëtar në lidhje me papunësinë, punësimin, zhvillimin e sektorit privat, aktivitetet e donatorëve të ndryshëm në lidhje me zhvillimin e punësimit në nivel lokal dhe oportunitetet për trajnim, kualifikim dhe ri-kualifikim.

2) Ka lindur nevoja për mbështetur në mënyrë të duhur zhvillimin lokal duke pasqyruar pamje të plotë dhe gjithëpërfshirëse e aktuale të cilësisë së jetës së qytetarëve, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. Shërbimet publike të njësitë e qeverisjes vendore janë përcaktuar për t'i shërbyer cilësisë së jetës së qytetarëve, por shpesh niveli i cilësisë së shërbimit ka qënë i dobët. Studimi i situatës mbi gjëndjen aktuale dhe ofrimi i statistikave të sakta, do të ndihmojë qeverisjen vendore në planifikim të saktë dhe të përshtatshëm për veprim.

Ish - Kënetë, Durrës

Zona e ish-Kënetës, Durrës, është e formuar nga një popullsi migratore e ardhur nga zona të thella malore veriore dhe jugore të Shqipërisë, pas viteve 90. Popullsia shkon në përafërsisht 60,000 banorë. Duke qënë zonë ish-moçalore, popullata përballet në mënyrë të vazhdueshme me probleme mjedisore, ekonomike, sociale, shëndetsore etj, si pasojë e mungesës së infrastrukturës, nivelit të ulët të shërbimeve publike, migrimit informal dhe mospërfshirjes në planifikimin urban të qytetit. Zona përballet gjithashtu me probleme të aksesit në shërbimet publike të arsimit, shëndetsisë, kopshte, çerdhe, linjave të transportit publik duke e bërë një zonë të paintegruar dhe të pazhvilluar.

Duke qënë se popullsia është migratore, e përbërë nga komunitete të ndryshme, të ardhura nga zona të thella urbane dhe sidomos rurale, nga gjithë Shqipëria, integrimi i tyre në jetën e qytetit të Durrësit mbetet një sfidë më vehte dhe bëhet akoma më i vështirë në kuadrin e punësimit sidomos të grave dhe të rinjve.

Pjesa më e madhe e popullsisë kanë arsim të ulët/mesëm, niveli i papunësisë, i dhunës në familje, i patriarkalizmit janë të larta, pra profili i popullsisë paraqitet me një nivel të ulët ekonomik dhe social. Ky profil kërkon ndihmë në drejtim të informimit, aksesimit dhe përdorimit të shërbimeve publike.

Deri më sot, për këtë popullsi dhe zonë nuk ka statistika të plota mbi popullsinë, gjendjen familjare, nivelin e arsimit, papunësisë apo dhunës në familje, të ndërmarra nga institucione publike, kurse të dhënat mbi zonën janë të fragmentuara në tematike dhe mbulim zonal, me QZHK Sot për te Ardhmen si i vetmi ofrues i shërbimeve komunitare për zonën.

Metodologjia

Ky vlerësim është bërë për papunësinë gjinore në zonën e Ish-Kënetës duke targetuar gratë dhe vajzat. Metodologjia e përdorur synon të paraqesë të dhëna dhe gjetje statistikore, të cilat do të shërbejnë për

marrjen e masave nga qeveria vendore në politikat vendore të trajtimit të problematikave, si dhe në ofrimin e shërbimeve sociale dhe publike në shërbim dhe mbështetje të grupeve në nevojë e veçanërisht grave e vajzave.

Metodologjia e zbatuar në këtë vlerësim është replikim i metodologjisë që është aplikuar me sukses nga "Sot për të Ardhmen"¹ për rajonet në veri të Shqipërisë, e cila vë në qendër të vlerësimit korrelacionin sasior dhe cilësor në lidhje me situatën e papunësisë së grave dhe vajzave, si dhe ndikimin e faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm në këtë vlerësim.

Në këtë aspekt, metodologjia fokusohet në analizimin e të dhënave nga terreni nëpërmjet intervistimit të drejtpërdrejtë të një kampioni të gjerë grash dhe vajzash dhe ndërthurjen e këtyre gjetjeve me të dhënat e institucionet publike si zyra e punës, gjendjes civile, bashki etj.

Kampionimi prej 380 intervistash të drejtpërdrejta paraqet një nivel besueshmërie 95%, me marzh gabimi prej +/- 5% për 60,000 banorë.

Intervistimi i 380 grave dhe vajzave është kryer në mënyrë rastësore, në 11 skolinat e zonës së ish-kënetës, duke mbuluar gjithë territorin e kësaj zone dhe popullsinë prej 60.000 banorësh.

Ky vlerësim është i shoqëruar dhe me një dokumentar, i cili pasqyron në mënyrë vizuale sa më sipër. Intervistimi është kryer nëpërmjet një pyetësi të hartuar duke patur në konsideratë: a) mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore, b) mbulimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, ndikues të drejtpërdrejtë dhe të ndërthortë c) sigurimin e pyetjeve konfirmuese në lidhje me saktësimin e të përgjigjeve të dhëna, d) sigurimin e përgjigjeve që mundëson analizë dhe statistika për disa institucione të referencës në Durrës, si gjendja civile, drejtoria arsimore, shërbimet sociale, zyra e punës, formimi profesional, përveç bashkisë dhe prefekturës si qeverisje vendore dhe qendrore.

Grupi i punës për intervistimin në terren u përgatit në mënyrë të veçantë mbi mënyrën e intervistimit duke patur parasysh dhe përjashtjen ndaj grave dhe vajzave të zonës së ish-kënetës.

Dy produktet e projektit (vlerësimi dhe dokumentari) marrin vlerë edhe më shumë duke qënë se ofrohet qeverisjes vendore dhe grupeve të interesit menjëherë pas zgjedhjeve vendore të qershorit 2015, dhe fillimit të administrimit vendor sipas reformës së re territoriale.

.....

1 Vlerësimi i Nevojave dhe Burimeve Sektoriale në Shkodër, Lezhë dhe Pukë – 2014, "Sot për të Ardhmen"



Vlerësimi i situatës së
papunësisë së
Grave dhe Vajzave në
zonën e Ish
Kënetës Durrës

Të përgjithshme

Qarku i Durrësit, sipas INSTAT, në vitin 2015 ka një popullsi rreth 276.191 banorë në total. Popullsia urbane është 229.641 banorë, ndërsa popullsia rurale 46.550 banorë. Qarku i Durrësit është një nga qarqet që ka përjetuar lëvizjet më të mëdha demografike kryesisht në vitet '90. Durrësi i Ri apo e njohur si Ish-Këneta, në fakt është një zonë e madhe ish-kënetore dhe e pabanuar para viteve '90. Me zënien e hapësirave publike nga lëvizjet migratore dhe kjo zonë u popullua në mënyrë galopante dhe kaotike, pavarësisht faktit si një zonë e pabanuar dhe e rrezikuar nga përmytjet dhe pa kanalizime urbane.

Lëvizja migratore dhe popullimi i zonës së ish-kënetës u shoqëruan me probleme të mëdha infrastrukturore, fillimisht bazuar në faktin se përveç mungesës së kanalizimeve apo elektrifikimit etj., sistemet e kanaleve kulluese të 11 parcelave të ish-kënetës u dëmtuan nga ndërtimet dhe banorët e rinj; si dhe gjithashtu u shoqëruan dhe me probleme të mëdha sociale si vështirësitë e integritetit të popullsisë migratore në jetën sociale të Durrësit, çështje të sigurimit të shërbimeve sociale, kulturore, rritja e nivelit të dhunës në familje, papunësia, niveli i ulët i arsimit, rritja e numrit të individëve në kundërshtim me ligjin, sidomos të rinjtë dhe burrat, mungesë e pritshmërive dhe apati sociale në përgjithësi.

Këto probleme sociale u shtuan dhe u ndërlikuan me rritjen e popullsisë, si probleme dhe pamjaftueshmëri e infrastrukturës për t'iu përgjigjur rritjes së popullësisë si në rrjetin rrugor, rrjetin energjetik, të furnizimit me ujë të pijshëm apo të largimit të ujrave të zeza, rritje të konsiderueshme të nivelit të ndotjes së ajrit, probleme me zënien e hapësirave publike dhe reduktimin e sipërfaqes së gjelbërt dhe shtimin kaotik me ritme të shpejta të ndërtimeve, administrimin jo të mirë mbeturinave urbane etj.

Në fakt, numri i popullsisë mendohet të jetë rreth 60.000 banorë, nga të dhënat e Census 2011², por statistika të mirëfillta për këtë zonë, nuk janë mbledhur në asnjë periudhë që nga popullimi i saj. Ish-Këneta mbulohet nga dy rajone të Bashkisë Durrës, Rajoni 5 dhe Rajoni 6 me popullsi respektivisht 34,999 dhe 34,015 si dhe pranohet që ndër rajonet që kanë zona informale me sipërfaqe dhe popullsi të konsiderueshme janë rajoni 4, 5 dhe 6³.

Nuk ka të dhëna gjithashtu mbi përqindjen që zë popullsia migratore dhe as për origjinat e migrimit.

Census-i i popullsisë 2011 evidenton një rritje popullsie prej 9% në qarkun e Durrësit, kryesisht në zonat urbane. Nga Censusi besohet se prurjet nga zonat verilindore të jenë në zonën e Ish-Kënetës.

Në këtë studim, një fokus i veçantë iu dha nxjerrjes së të dhënave mbi përqindjen që zë popullsia migratore dhe origjinën e tij, duke patur parasysh ndihmesën që i jep qeverisjes vendore mbi lloje të veçanta të shërbime sociale dhe komunitare që ndikohen nga tipologjia e grupeve komunitare dhe mentalitetit apo kulturës së origjinës së tyre.

.....
2 Census 2011, të dhënat janë për qarqe dhe rrethe - INSTAT


3 “Program i zonës funksionale – Bashkia e Re Durrës” – Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Popullsia e Ish-Kënetës

Nga kampionimi rezulton se popullsia tashmë e Ish-Kënetës është e përbërë prej 95% banorë të migruar dhe vetëm 5% janë vendas (të ardhur nga fshatrat e Durrësit përreth zonës).

Nga ana tjetër, përbërja e tyre rezulton të jetë: **48% nga Shqipëria Jugore** kryesisht nga Berati, Gramshi dhe Berati, **36% nga Shqipëria Veriore**, kryesisht nga Mirdita, Puka, Kukës, **10% nga Shqipëria e Mesme** dhe kryesisht Elbasani, dhe **1% nga Diaspora me kryesisht Kosovën** dhe Çamërinë. **Graf. 1**

Përbërja e Popullsisë në Zonën e Ish-Kënetës, Durrës



Graf. 1

Përbërja e Popullatës sipas Kampionimit

Sipas kampionimit grupmosha deri në 18 vjeç përbën rreth 30% të popullatës së përgjithshme të zonës së Ish-Kënetës.



Kampionimi është ndarë në grupmoshat “Deri në 16 vjeç”, “16 – 18 vjeç” dhe “Mbi 18 vjeç”. Siç shihet dhe në **Graf. 2**, numri i përgjithshëm i gjinisë femërore vjen duke rënë nga 53% në 50% në lindjet e reja. Në përgjithësi, përbërja gjinore mesatare e popullatës së zonës së Ish-Kënetës është **e barabartë**.

Këto rezultate përputhen me rezultatet e anketuara nga Instati dhe të botuara në botimin “Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2015⁴”, si dhe me trendin e përgjithshëm gjinor në Bashkinë Durrës, Censurit të vitit

4

Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2015, ndryshimet në popullsi - INSTAT


Përbërja e gjinore sipas grupmoshave



Graf. 2

2011, ku popullsia e përgjithshme e zonës funksionale është 175,110 banorë dhe përbërja gjinore është pothuajse e barabartë 87,613 meshkuj dhe 87,497 femra.

Përbërja e Familjare e popullsisë sipas kampionit



Graf. 3

Të dhënat e kësaj zone, ndihmojnë institucionet vendore dhe qeverisjen vendore për marrjen e masave në politikave vendore me bazë perspektivën gjinore.

Përbërja familjare

Një element tjetër për t'u analizuar si pjesë e fushëpamjes së gjerë të papunësisë, është dhe përbërja familjare. Ky element është i rëndësishëm për masën e konsiderimit si faktor ndikues. Siç do të shikojmë më poshtë, përbërja familjare jo vetëm që është faktor ndikues në papunësinë e grave dhe vajzave, por edhe një faktor që duhet marrë në konsideratë nga qeverisja vendore mbi shërbimet sociale dhe komunitare në zonë.

Rezulton se 48,5% e kampionimit kanë 5 deri në 6 anëtarë në familje, 13.3% mbi 6 anëtarë, dhe vetëm 36% kishin 3-4 anëtarë e 2.3% 0-2 anëtarë.

Duke arsyetuar që mbi **60% e familjeve të të intervistuarave janë me +5 anëtarë**, e bën të vështirë punësimin e grave dhe vajzave dhe nga ana tjetër jep indikatorë për institucionet e shërbimeve sociale që të fokusohen në shërbime sociale e komunitare shtesë për këto familje.

Graf. 3

Statusi civil i të intervistuarave

Sigurisht që statusi civil është një faktor që në varësi të kulturës, origjinës dhe grupit social ka nivel të ndryshëm ndikues në nxitje të punësimit e karrierës apo me efekt të kundër, në frenim të zhvillimit individual të karrierës e punësimit. Duke qënë një zonë migratore, statusi civil është në korelacion të fortë me faktorët e tjerë të mësipërm si dhe varion nga një grup migrator në tjetrin, duke e bërë një faktor ndikues të konsiderueshëm në lidhje me punësimin/papunësinë e grave dhe vajzave.

Në lidhje me këtë, gjetjet janë 75% të martuara, 21% beqare, 2% të divorcuara dhe 1% vejusha.

Është e nevojshme të theksohet që përqindja e lartë e grave të martuara, divorcuara apo vejushave (pa lënë mënjanë problematikat e grupit të beqareve), është e lidhur me numrin e lartë të përgjegjësive të tyre brenda familjeve, sidomos kur rezulton se 60% e familjeve janë mbi 5 pjesëtarë.


Ky grup mbart dhe shumë problematika të tjera që do të shtjellohen në vazhdim dhe që janë pengesa për punësimin, kualifikimin e karrierën e tyre. **Graf.4.**

Ky përfundim mbështetet dhe nga të dhënat e nxjerra në lidhje me arsimimin e tyre.

Niveli i Arsimit


Graf. 5 paraqet të dhënat mbi nivelin e përgjithshëm arsimor të grave dhe vajzave, me 51% me arsim 7 deri 9 vjeçar, 32% të mesëm,

Gjendja civile e grave dhe vajzave sipas kampionit



Graf. 4

Niveli arsimor i grave të zonës së Ish-Kënetës



Graf. 5

■ Arsimit fillor
■ Arsimit i mesëm
■ Arsimit i lartë

Arsimi Fillor	1%	Deri 9 vjeçar	51%
I mesëm	32%	I lartë	16%
përgjithshëm 90% Profesional 10%			

dhe vetëm 16% të lartë, në korelacion të drejtë me trendin e përgjithshëm në Shqipëri⁵.

Gjithashtu, vihet re që nëse arsimi i mesëm zë 32%, brenda tij, ndjekja e arsimit të mesëm të përgjithshëm është në nivelin 90%, kurse arsimi profesional zë 10% (në nivelin e përgjithshëm, *arsimi profesional zë vetëm 3%*).


Mosha mesatare sipas arsimit

Ndërkohë **Graf. 6** jep dhe korelacionin e moshës mesatare sipas nivelit të arsimit, ku rezulton që mosha mesatare e të intervistuarave *pa arsim është 44 vjeç, me arsim fillor është 54 vjeç, me arsim 7 deri 9 vjeçar është 40 vjeç, kurse për arsimin e mesëm është 35 vjeç*, dhe që u referohet në pjesën dërrmuese grave të martuara, me pjesëtarë të tjerë në familje, me familje të mëdha.

Ndërkohë që mosha mesatare e të intervistuarave me arsim të lartë është 25 vjeç dhe do shohim në vijim pasqyrimin e fenomenit të papunësisë të rinjve me arsim të lartë.

Gjithashtu vihet re që mosha mesatare e të intervistuarave me arsim të mesëm është 35 vjeç, por brenda grupimit, mosha mesatare e të intervistuarave me arsim të mesëm të përgjithshëm është *33 vjeç*, kurse me arsim të mesëm profesional është *43 vjeç*.

Devianca shpjegohet me raportin 9:1 të arsimit të mesëm të përgjithshëm ndaj atij profesional. (dhe trendi kombëtar për vitin 2014, jep të njëjtin raport, sipas INSTAT). Do të shohim në vijim dhe marrëdhënien e tyre me punësimin/papunësinë.




Graf. 6

Mosha mesatare sipas arsimimit

⁵ Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2015, niveli arsimor i popullsisë në % - INSTAT

Raporti i punësimit / papunësisë së grave dhe vajzave

Graf. 7




Papunësia femërore sipas kampionimit

Sipas intervistimit të kampionimit, rezulton se brenda gjinisë femërore, papunësia është në nivelin 57%. **Graf. 7.**

Sipas të dhënave të zyrës së punës Durrës, regjistrimi i punëkërkuesve të papunë për gjithë Durrësin për vitin 2014 ka qënë 8,956 kurse të punësuar rreth 3,000, ose 33% (meshkuj, femra).

Niveli arsimor i grave të popuna

Graf. 8



Niveli Arsimor i Grave dhe Vajzave të Papuna

Për të analizuar disa prej faktorëve kontribues në papunësinë e grave dhe vajzave, faktori kryesor i marrë në analizë është arsimi i tyre.

Siç shihet dhe nga **Graf. 8**, 18.5% e grave dhe vajzave të papuna janë me arsim të lartë, 24.5% janë me arsim të mesëm, 55% janë me arsim 7 deri 9 vjeçar dhe 2% janë me arsim fillor ose pa arsim.

Sipas të dhënave të ZP Durrës, për vitin 2014 (meshkuj, femra) rezulton se niveli i arsimimit i punëkërkuesve të papunë është 11% arsim i lartë, 39% arsim i mesëm, dhe 51% arsim deri 9 vjeçar (meshkuj, femra).

Deviancat mes kampionimit dhe të dhënave të ZP Durrës vijnë si rezultat i ndryshimit në targetim (kampionimi – vetëm femra, ZP – femra, meshkuj të regjistruar si punëkërkues të papunë), si dhe pjesëmarrjes më të lartë të femrave në arsimin e mesëm dhe të lartë se të meshkujve sipas të dhënave të INSTAT.

Papunësia sipas grupmoshave krahasuar me numrin e përgjithshëm të grave të papuna

Përveç arsimit, niveli i papunësisë është analizuar dhe sipas grupmoshës për të parë tendencën se në cilën grupmoshë, papunësia është më e lartë apo më e ulët. Përveç krahasimit midis grupmoshave, janë nxjerrë të dhëna dhe për papunësinë brenda grupmoshës.

Graf. 9 tregon se: *në numrin e përgjithshëm të grave dhe vajzave të papuna*, përqindja më e lartë e papunësisë vihet re në grupmoshën 18-29 vjeç (42%), pothuajse dyfish krahasuar me nivelin e papunësisë për grupmoshat 30-40 vjeç dhe 41-50 vjeç, apo mbi 50 vjeç.

Megjithatë, meqenëse kampionimi ka targetuar gra dhe vajza në mënyrë rastësore, për të kufizuar marxhin e gabimit që mund të vijë nga pabarazitë e numrit të intervistuarave në këto grupmosha, u analizua niveli i papunësisë dhe brenda grupmoshës.


Rezultoni që niveli i papunësisë brenda grupmoshave është më i lartë, se sa papunësia midis grupmoshave, ndërkohë që vihet re se niveli i papunësisë është në korelacion pozitiv me rritjen e moshës duke filluar nga 30 vjeç (pa futur faktorët e tjerë kontribues).

Për grupmoshën 18-29 vjeç, 65% e tyre janë të papuna, që tregon për ndikimin e lartë të faktorëve të tjerë kontribues në papunësinë brenda kësaj grupmoshe të re, siç mund të jetë arsimi apo mospërputhja e tregut të punës me formimin arsimor.

Të dhënat janë në korelacion të drejtë dhe me trendin e përgjithshëm përse i përket shkallës së papunësisë për femrat sipas grupmoshave⁶.

6 Anketa e Forcave të punës 2012 – 2014 - INSTAT

Papunësia dhe moshë



Graf. 9

Për të krahasuar këto gjetje me të dhënat e zyrës së punës Durrës (bazuar në numrin e punëkërkuesve të papunë të regjistruar), hasen vështirësi në metodologjinë e përpunimit të tyre. Sipas të dhënave, ndarja e grupmoshave nga zyra e punës Durrës është deri 25 vjeç, 26-45 vjeç dhe mbi 45 vjeç. Mospërpunimi i të dhënave sipas metodologjisë së INSTAT e vështirëson krahasimin. Për vitin 2014, papunësia në Durrës (meshkuj + femra) është: 19% deri në 25 vjeç, 41% [26-45] vjeç dhe 39% për moshat mbi 45 vjeç.

Krahasimi i përafërt i mundshëm është që sipas kampionimit të studimit, grupmosha deri në 40 vjeç zë 62.3% të numrit të përgjithshëm të grave të papuna, ndërsa sipas ZP Durrës (viti 2014) grupmosha deri në 45 vjeç zë 60.5% (meshkuj, femra) të numrit të përgjithshëm të punëkërkuesve të papunë të regjistruar (meshkuj, femra)

Niveli Mesatar i papunësisë sipas grupmoshave

*Mesatarja e papunësisë paraqitet në **Tab. 1** sipas grupmoshës së kampionimit:*

Grupmosha	Mesatarja e nivelit të papunësisë (kampionimi) 2015	Shkalla e papunësisë në rang vendi 2014 ⁷
15-29	28%	27.4%
30-64	13.8%	12.3%

Korelacioni arsim - papunësi në grupmoshë

Për të parë më ngushtë, arsyet e nivelit të papunësisë së lartë mes grupmoshave, dhe sidomos brenda grupmoshës, **Tab.2**, tregon korelacionin e lidhjes arsim-papunësi (në numrin e përgjithshëm të intervistuarave të papuna) brenda grupmoshave të marra në konsideratë.

⁷
Anketa e Forcave të punës 2012 – 2014 - INSTAT

Vihet re se për grupmoshat 30 – 60 vjeç përveç faktorit moshë që kontribuon në rritjen e e papunësisë, faktor tjetër ndikues është niveli i arsimit. 60 - 72% e kësaj moshe janë me arsim 7- 8 vjeçar, ndërkohë dhe papunësia është në nivelin 68 - 77% e grave të kësaj grupmoshe me këtë nivel arsimit.

Ndërkohë që niveli i papunësisë paraqitet në norma më të ulta për grupmoshën 30-60 vjeç me arsim të mesëm. Është për t'u theksuar që papunësia e grave me arsim të mesëm profesional është më e ulët se atyre me arsim të mesëm të përgjithshëm.

Për sa i përket grupmoshës 19 – 29 vjeç, niveli mesatar i papunësisë është 28%, megjithatë ndryshe nga grupmoshat e tjera, 35% e tyre janë me arsim të mesëm dhe 40% janë me arsim të lartë, ndërkohë që papunësia më e lartë vihet re në të rinjtë me arsim të lartë (45%) dhe me arsim të mesëm (31%).

Kjo mbështet analizën e bërë në “Papunësia sipas Grupmoshave” që përveç arsimit, mospërputhja e tregut të punës me formimin arsimor është një faktor kyç.

Grupmosha	Pesha në kampionim	Arsim & papunësi	Pa arsim	Fillore	7/8/9 vjeçare	E Mesme	I Lartë
-18	1%	Niveli i arsimit	0%	0%	100%	0%	0%
		Niveli i papunësisë	0%	0%	100%	0%	0%
19-29	35%	Niveli i arsimit	0%	0%	25%	35%⁴	0%
		Niveli i papunësisë	0%	0%	25%	31%⁴	5%
30-40	27%	Niveli i arsimit	0%	1%	69%	26%	4%
		Niveli i papunësisë	0%	2%	77%¹	8%	2%
41-50	22%	Niveli i arsimit	1%	0%	60%	38%	1%
		Niveli i papunësisë	2%	0%	68%²	9%	0%
51-60	14%	Niveli i arsimit	0%	2%	72%	21%	6%
		Niveli i papunësisë	0%	3%	77%¹	8%	3%
+61	1%	Niveli i arsimit	0%	100%	0%	0%	0%
		Niveli i papunësisë	0%	100%	0%	0%	0%

Niveli i kualifikimit i të papunëve



Graf.10

Pu.papunë të regjistruar dhe me ndihmë ekonomike në familje në raport me situatën e përgjithshme të papunësisë



Graf.11

Niveli i kualifikimeve të grave të papuna, ndihma ekonomike në familjet e tyre dhe pu.papunë të regjistruar

Nga niveli i përgjithshëm i të intervistuarave të papuna, **21% e tyre kanë kryer kualifikim shtesë**, por që rezultoi që përsëri kualifikimi shtesë nuk ka rezultuar në gjetjen e një vendi pune.

Shumica e kualifikimeve shtesë është bërë në kurse si "Parukeri", "Rob-aqepsi", "Anglisht", "Italisht", "Gazetari".


Kualifikimi ka qenë afatshkurtër dhe në nivel bazë, ndërkohë kërkesa për forcë pune në këto profile është e vogël dhe / ose kërkohet me kualifikim më të lartë se mesatarja. Gjithashtu gjuhët e huaja janë aftësi shtesë në profilin e punës me një profesion bazë. **Graf.10**

Ndërkohë, vetëm **14%** e familjeve të të intervistuarave përfitojnë ndihmë ekonomike dhe vetëm **19%** e të intervistuarave të papuna janë regjistruar në zyrat e punës si punëkëruese të papuna. **Graf. 11**

Faktorët Primarë ndikues në Nivelin e Papunësisë dhe Nënkatëgoritë e tyre

Në përfundim të marrjes në shqyrtim të elementëve të ndryshëm kontribues dhe përshkrues të situatës së papunësisë femërore, u analizuan

dhe renditën dhe Faktorët Primarë dhe Nënkatëgoritë e tyre sipas ndikimit që kanë në nivelin e përgjithshëm të papunësisë. **Graf.12**



Graf.12

Rezultojnë se faktorët primarë ndikues në papunësi janë:

Situata e përgjithshme e papunësisë	61%
Familja	19%
Arsimi	11%
Shëndeti	5%
Dhuna në familje	4%

Në lidhje me Faktorin Primar “Situata e përgjithshme e papunësisë”, u renditën dhe nënkategoritë brenda këtij faktori primar si:

*Mungesa e Vendeve të Punës me 80%,
Mungesa e Kualifikimit 11% dhe
Diskriminimi Moshor 9%.*

Në lidhje me Faktorin Primar “Familje”, vihen re dy nënkategoritë:

*“Kujdesi ndaj fëmijëve” me 88% dhe
“Kujdesi/Shërbimi ndaj pjesëtarëve të tjerë në familje” 12%.*

Në faktorin primar të “Arsimit” theksi vihet te *mungesa e përputhshmërisë së formimit arsimor me kërkesat e tregut të punës.*

Në faktorin primar të “Shëndetit”, vihen re *barriera për njerëzit me aftësi të kufizuara, mungesë e trajtimit të diferencuar apo ofrim i vendeve të punës pa përshtatje për njerëz me probleme shëndetsore.* Në faktorin primar të “Dhunës në Familje” pavarësisht pjesës prej 4% të raportuar, dhuna në familje mendohet të jetë më e lartë.

Vetëm dy tipologji të dhunës janë dhënë nga të intervistuarat: *fizike dhe psikologjike*, ndërkohë që dhuna ekonomike apo forma të tjera nuk janë të identifikueshme prej tyre.

Gjithashtu vihet re se dhunues në të gjitha rastet është identifikuar *bashkëshorti apo partneri (i fejuari), kurse dhuna nga pjesëtarë të tjerë të familjes sidomos vjehri, vjehrra nuk kuptohet si e tillë.*

Vëmë në dukje se këto faktorë dhe nënkategoritë e tyre janë indikatorë të drejtëpërdrejtë për ri-shikimin e politikave vendore në lidhje me punësimin e grave dhe të rejave, me shërbimet sociale për mbështetjen e punësimit të grave me fëmijë, kualifikimin nëpërmjet formimit profesional sipas kërkesave të tregut të punës, trajtimin e punës për njerëzit me aftësi të kufizuara, apo marrjen e masave për eliminimin e dhunës në familje dhe edukimit qytetar.



Punësimi femëror


Punësimi femëror

Përveç trajtimit të të dhënave dhe nxjerrjen e përfundimeve sasore dhe cilësore për papunësinë e grave dhe vajzave në zonën e Ish-Kënetës Durrës, është e nevojshme të paraqitet dhe një situatë mbi faktorët kontribues të grave dhe vajzave të Ish-Kënetës që punojnë, për të parë se çfarë sektori ofron mundësi punësimi, tipologjinë e punës dhe të arsimit etj.

Siç është treguar në “Papunësia femërore sipas kampionimit” Graf 7., gratë dhe vajzat e punësuar përbëjnë 43% të kampionimit të intervistuar.

Ndër këto, puna e kryer në sektorin e administratës shtetërore/institucione publike është në nivelin 5% dhe në sektorin privat është 95%. **Graf. 13**

Raporti i punësimit Sektor Privat / Administratë shtetërore



Graf.13

Punësimi sipas arsimit në sektorë

Të dy këto sektorë: “*Administratë shtetërore/institucione publike*” dhe “*Sektor Privat*” janë shqyrtuar në lidhje me të punësuarat sipas arsimit. **Tab. 3**

Bazuar në numrin e përgjithshëm të grave të intervistuarat sipas arsimit që kanë, punësimi i atyre që janë me arsim të lartë është **39%** (17% e grave me arsim të lartë punojnë në administratë shtetërore/institucione publike dhe 83% në sektorin privat) në të njëjtin nivel me gratë dhe vajzat e punësuarat me arsim 7 deri 9 vjeçar **39%** (por me përqendrim 100% në sektorin privat).

Arsimi G		jithsej		Administratë shtetërore		Sektor Privat	
I lartë		39%		17%		83%	
I Mesëm	Profesional	54%	58%	6%	3%	94%	8%
	I përgjithshëm		53%		3%		92%
7/8/9 vjeçar		39%		0%		100%	

Kurse, të punësuarat me arsim të mesëm zënë pjesën më të madhe me **54%**.

Vetëm **6%** e grave me arsim të mesëm punojnë në administratë shtetërore/institucione publike (me një ndarje të barabartë arsim profesional/ipërgjithshëm), dhe pjesa tjetër prej **94%** e grave me arsim të mesëm punojnë në sektorin privat me një ndarje të pabarabartë (**92%** me arsim të mesëm të përgjithshëm, dhe vetëm 8% me arsim të mesëm profesional).


Kjo ndarje vjen si pasojë e raportit të ulët të grave me arsim profesional krahasuar me atë të përgjithshëm (1 me 9).

Nëse do të shikonim punësimin e dy tipologjive të arsimit të mesëm, rezulton që punësimi i grave dhe vajzave *me arsim të mesëm profesional është në nivelin 58%* dhe i grave dhe vajzave *me arsim të mesëm të përgjithshëm është 53%.*

Në nivel kombëtar për tremujorin e katërt 2014, sipas anketës së forcave të punës, trendi mbështetet me nivelin e përgjithshëm: *“shkalla e punësimit është më e lartë për personat me arsim të mesëm profesional krahasuar me personat që kanë kryer shkollën e mesme të përgjithshme, përkatësisht 65,5 dhe 45,5 %”.*

Të ardhurat sipas sektorit të punësimit

Është gjithashtu e rëndësishme të shihet dhe cilësia e punësimit të grave dhe vajzave në këndvështrimin e të ardhurave. **Graf. 14**



Numri i grave të paguara sipas kategorive të pagave për të dy sektorët shkojnë në **kahe të ndryshme** (për sektorin privat numri i grave dhe vajzave të punësuar bie me rritjen e pagës, kurse në sektorin e administratës shtetërore/institucione publike është në përgjithësi në korelacion pozitiv me kategorinë e pagave).

Vihet re se përqindja më e madhe e grave të punësuar në sektorin privat (**30%**) kanë të ardhura neto në nivelin **15,000 – 20,000 lekë** dhe vijon me **19%** me të ardhura neto në nivelin **10,000 – 15,000 lekë**.

Për sektorin e administratës shtetërore/institucione publike përqindja më e madhe e grave të punësuar (**38%**) kanë të ardhura neto **25,000 – 30,000 lekë** dhe vijon me **25%** me të ardhura neto mbi **40,000 lekë**.


Këto rezultate janë në korelacion të drejtë me rezultatet dhe të dhënat e INSTAT⁸.

Tipologjia e punës dhe informaliteti ndërsektorial

Analiza për nxjerrjen e të dhënave në **Graf. 15** është bazuar në dy kategori: **përpunimi i të dhënave sipas tipit të punës** (me kohë të plotë/ me kohë të pjesshme/të vetpunësuar) dhe mbulimit me sigurime shoqërore dhe shëndetsore (me/pa sigurime shoq&shënd.)

8
Llogaritje të INSTAT bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve – “Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2015”

Tipologjia e punës dhe informaliteti ndërsektorial



Vihet re një përputhje midis tipit dhe formalizimit të punës:

Për sektorin privat

59% e grave të punësuar me kohë të plotë janë dhe me sigurime të paguara.

18% e grave të punësuar me kohë të pjesshme janë pa sigurime (në të zezë)

23% e grave të vetpunësuar nuk i kanë dhënë përgjigje çështje së sigurimeve, duke dalë në konkluzion se vetpunësimi është informal.

Niveli i informalitetit brenda sektorit privat rezulton **41%**

Për sektorin e administratës shtetërore/institucione publike

100% janë të punësuar me kohë të plotë dhe me sigurime shoqërore.

Në total, niveli i informalitetit është 39%

Punësimi sipas gjinive


Të pyetura dhe për meshkujt në familjet e tyre në punë/pa punë, të dhënat japin një panoramë të tillë:

2 nga 5 gra punësohen, dhe 2 nga 3 burra punësohen. Graf. 16




Graf.16

Kurse **raporti i punësimit midis grave dhe burrave është 3 me 5. Graf. 17**



Graf.17



Konkluzione dhe
Rekomandime

Konkluzione

- Zona Ish-Kënetës në Durrës është e përbërë nga 95% popullsi migratore (rreth 48% nga Shqipëria Jugore, 36% nga Shqipëria Veriore, 10% nga Shqipëria e Mesme dhe 1% nga Diaspora). Nga ana administrative zona është nën Rajonin 5 dhe 6 të Zonës së re funksionale Durrës, si dhe me mungesa të mëdha në infrastrukturë, shërbime sociale dhe publike. Zona ka një shkollë të mesme “E Re” dhe një 9 vjeçare “Don Nikoll Kaçorri”, dy qendra shëndetsore për një numër banorësh që mendohet të jetë rreth 60.000 banorë, ndërkohë nuk ka kopshte publike. “Sot për të Ardhmen” është e vetmja qendër komunitare në shërbim të grupeve të ndryshme komunitare. Problemet e varfërisë, papunësisë, dhunës në familje dhe mosintegritimit social janë evidente, ndërkohë që dhe problemet mjedisore dhe infrastrukturore janë të mëdha.
- Përbërja gjinore është pothuajse e barabartë. 60% e familjeve janë me 5 e më shumë anëtarë në familje, kurse 75% e grave janë të martuara. Si zonë migratore, statusi familjar i grave është i lidhur ngushtë me nivelin kulturor, origjinën e familjeve dhe grupimin social që i përkasin dhe së bashku ndikojnë në punësim, kualifikim e më tej në karrierë apo status social të tyre.
- Rreth gjysma e grave dhe vajzave (51%) janë me arsim deri në 9 vjeçar. Gratë dhe vajzat që janë me arsim të mesëm profesional zënë vetëm 3% në nivelin e përgjithshëm arsimor, por perspektiva e punësimit të tyre është më e lartë se atyre që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm (respektivisht 58% krahasuar me 53%).
- 53% e grave dhe vajzave rezultojnë të papuna. Sipas arsimit, rezulton se 55% e grave të papuna janë me arsim deri në 9 vjeçar, 25% me arsim të mesëm, dhe 19% me arsim të lartë. Për gratë dhe vajzat 19-29 vjeç, me arsim të lartë vihet re një normë e lartë papunësie (45% e tyre) si pasojë e mospërputhjes së tregut të punës me formimin arsimor.

- Papunësia e shqyrtuar sipas grupmoshës tregon që grupmosha 18-29 vjeç zë 42% të numrit të përgjithshëm të të papunave e ndjekur me 20% nga grupmosha 30-40, 19% nga grupmosha 40-50 etj. Brenda grupmoshave vihet re se 65% e grave të grupmoshës 18-29 vjeç është 65%, dhe 74% e grave të grupmoshës mbi 50 vjeç, ndërkohë që më ulët papunësia rezulton te gratë e grupmoshës 30-40 vjeç me 42% të tyre.
- Ndërsa ndihma ekonomike përfitohet vetëm nga 14% e familjeve, 19% e grave të papuna janë të regjistruara në zyrën e punës si punëkërkuese të papuna. Ndërkohë 21% e grave të papuna rezultojnë të kenë kryer kualifikime shtesë në formën e kurseve afatshkurtra por që në tregun e punës janë ose profile që kanë shanse për vetëpunësim ose profile që tregu i punës kërkon kualifikim më të lartë, përpos faktit të nivelit më të lartë të kërkesës ndaj ofertës së tregut të punës.
- Faktorët primarë që ndikojnë në nivelin e papunësisë së grave dhe vajzave janë: Situata e përgjithshme e papunësisë 61%, Familja 19%, Arsimi 11%, Shëndeti 5%, Dhuna në familje 4%. Këto faktorë janë shqyrtuar në nënkategori dhe rezultojnë: Mungesa e vendeve të punës, mungesa e kualifikimit, diskriminimi moshor, kujdesi ndaj fëmijëve, kujdesi / shërbimi ndaj pjesëtarëve të tjerë në familje, mungesa e përputhshmërisë së formimit arsimor me kërkesat e tregut të punës, barriera për njerëzit me aftësi të kufizuar, mungesë e trajtimit të diferencuar apo ofrim i vendeve të punës pa përshtatje për njerëz me probleme shëndetsore, dhunë fizike dhe/ose psikologjike nga bashkëshorti/partneri.
- 39% e grave dhe vajzave me arsim të lartë, 54% e grave dhe vajzave me arsim të mesëm dhe 39% e grave dhe vajzave me arsim 7-9 vjeçar janë të punësuar. Nga numri i përgjithshëm i grave dhe vajzave që punojnë, 95% punojnë në sektorin privat. Të ardhurat për të punësuarat shkojnë në kahe të ndryshme: për sektorin privat numri i grave me të ardhura të larta vjen në zbritje, kurse në administratë shtetërore / publike vjen në rritje (për një rang deri në 50,000 lekë). Të ardhurat më të shpeshta neto prej 15,000 – 20,000 lekë vihen re të gratë e punësuar në sektorin privat

me 30%, kurse të ardhurat neto më të shpeshta për sektorin e administratës shtetërore/institucione publike janë 25,000-30,000 me 38% të grave dhe vajzave të punësuar.

- Niveli i informalitetit është 39%. Qasja mes gjinive tregon për 2 në 5 gra që punësohen krahasuar me 2 në tre burra që punësohen. Raporti i punësimit gjinor është 3 gra krahasuar me 5 burra.

Rekomandime

- Sistemi i ri i organizimit territorial dhe reforma e pushtetit lokal japin mundësi që të përmirësohen e të dixhitalizohen të dhënat mbi popullsinë, arsimin, ndihmën ekonomike, punësimin, pronat dhe pasuri të tjera të luajtshme e të paluajtshme, për të krijuar mundësi të formalizimit të kësaj zone dhe rikualifikimit urban të saj, por edhe për të zhvilluar ndërhyrje sa më efektive si për punësimin dhe përkujdesjen gjinore.

- Bashkëpunimi mes qeverisjes vendore dhe institucioneve publike, shoqërisë civile dhe sektorit privat, sidomos pas platformës për ngritjen e Parkut Energjetik Kombëtar në këtë zonë, do të përbënte platformën ideale për të mundësuar formalizimin e zonës dhe nxitjen e punësimit, sidomos të grave dhe të rinjve.

- Nga ana tjetër, për zonën duhet të ketë një vëmendje e prioritet më të madh në Planin Strategjik të qytetit të Durrësit dhe në Planin e Veprimit të përfshirjes sociale, në lidhje me mundësimin e shërbimeve publike në zonë si: çerdhe, kopshte, transport publik, të cilat jo vetëm janë baza e integritit social të popullatës së zonës, por në lidhje me gratë dhe vajzat janë dhe ndihmesë në sigurimin e kohës së nevojshme për të punuar, si dhe në cilësinë e jetës së tyre, duke tkurrur nga ana tjetër dhe punën e papaguar në familje.

- Faktorët primarë dhe nënkategoritë e tyre në papunësinë femërore të nxjerra në këtë vlerësim janë indikatorë të drejtpërdrejtë, të cilët qeverisja vendore në bashkëpunim dhe me qeverisjen qendrore duhet t'i përdorë si baza statistikore dhe cilësore për rishikimin e politikave vendore në lidhje me punësimin e grave dhe të rejave, me shërbimet sociale për mbështetjen e punësimit të grave me fëmijë, kualifikimin nëpërmjet formimit profesional sipas kërkesave të tregut të punës, trajtimin e vendit të punës për njerëzit me aftësi të kufizuara, apo marrjen e masave për eliminimin e dhunës në familje dhe edukimit qytetar, si dhe për të matur cilësinë e shërbimeve dhe zbatimit të këtyre politikave nga institucionet e referencës.
- Duke qenë se më shumë se gjysma e grave të papuna kanë arsim deri në 9 vjeçar, qeverisja vendore dhe sidomos zyra e punës mund të iniciojnë programe afatshkurtra të edukimit të përgjithshëm, si dhe trajnime profesionale intensive dhe të përshtatura sipas nevojave në kohë apo vendodhje, në kategori të kërkuara nga punëdhënësit dhe sipas kërkesave të tregut të punës në lidhje me kualifikimet e kërkuara, dhe në bashkëpunim me OJF vendore që punojnë në terren.
- Në kuadër të proceseve të integritetit, në të cilat është përfshirë Shqipëria, pjesëmarrja e bashkisë së Durrësit në projekte të ndryshme mund të vërë theksin në këtë zonë, duke i kushtuar rëndësi të veçantë trajnimeve kualifikuese dhe rikualifikuese për popullatën femërore të papunë apo të nënpunësuar, kryesisht në sektorin e turizmit dhe shërbimeve ku në fakt, bashkia e Durrësit dhe të tjera fqinje me të kanë rol të rëndësishëm.
- Politikat vendore të punësimit duhet të mbështeten me platforma informative, publikimi dhe transparence në lidhje me dinamikën e tregut të punës, llojet e ofertave të punës dhe kualifikimet e kërkuara, tendencat dhe lëvizjet sasiore dhe cilësore të industrive me kërkesa të larta për forcë pune, planet dhe programet kualifikuese dhe atraktive për të rinjtë apo mbështetëse për gratë, dhe sidomos për grupet e veçanta si gratë në nevojë, pa ndihmë ekonomike, me fëmijë, me probleme shëndetsore apo me aftësi të veçanta, etj.

BIBLIOGRAFI

- Të dhëna të përpunuara, 380 pyetësorë, zona Ish-Kënetë, Durrës – Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, www.cdc-tff.org
- Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2015 – INSTAT, www.instat.gov.al
- Anketa e Forcave të Punës 2012 -2014 – INSTAT www.instat.gov.al
- Anketa tremujore e Forcave të Punës 2014 – Tremujori IV – INSTAT, www.instat.gov.al
- Census i Popullsisë 2011 – INSTAT, www.instat.gov.al
- Program i zonës funksionale – Bashkia e Re Durrës – Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, www.cdinstitute.eu, www.shtetiweb.org
- Vlerësimi i Nevojave dhe Burimeve Sektoriale në Shkodër, Lezhë dhe Pukë, 2014 – Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, www.cdc-tff.org
- Të dhëna nga Bashkia, Zyra Punës, Gjendja Civile Durrës, www.durres.gov.al



*Grafika NoCity - Saki Hajdari, Urban Sketchers Albania;
Dokumentari NoCity - Kompania Bunker Film, Regjia Ajola Daja.*

*Falenderojmë Saki Hajdarin për këndvështrimin artistik nëpërmjet grafikës NoCity të ish kënetës së Durrësit,
si dhe Viola Detin për ndërmjetesimin e Urban Sketchers Albania.*

*Si dhe falenderojmë Kompaninë Bunker Film, për dokumentarin e shkurter NoCity, që vjen si pjesë reale dhe
e jetuar e këtij studimi.*



SOT PËR TË ARDHMEN

Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” është një organizatë lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë. E udhëhequr nga vizioni i organizatës “Sot për të Ardhmen” dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, QZHK “Sot për të Ardhmen” ka krijuar përjasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve, përfshirjes dhe mobilizimit komunitar.

QZHK “Sot për të Ardhmen” - Durrës

L.17, Rr. “Rinia Durrsake, Skolina 5, ish-Kënetë, Durrës, Shqipëri

Kutia Postare (POBOX) 537 / Tel/Fax +355 52 90 10 71 / Tel: +355 52 90 10 70 / +355 42 30 24 10

Tel falas: 080098 88 / e-mail: info@cdc-tff.org

 www.facebook.com/AlbanianCommunityCentre

 www.youtube.com/SotPerTeArdhmen

 www.twitter.com/SotPerTeArdhmen

 www.cdc-tff.org

